



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:146055

Datë: 22.03.2021

Numri i dokumentit: 01620947

C.nr. 937/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Raif Fazliu në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.N nga fshati Beguncë, Komuna e Vitisë, të cilin me autorizim e përfaqëson Liman Musa, avokat në Ferizajt, kundër të paditurës K.N.P.SH. “Papenburg & Ardiani Company” me seli në Sojevë të Ferizajt, të cilën e përfaqëson Hajredin Leka avokat në Gjilan, lidhur me padinë për kompensimin e dëmit material dhe jo material, pas mbajtjes të shqyrtimit kryesor në praninë e palës paditëse e në mungesë të paditurës më datë 16.03.2021, bie këtë:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.N nga Begunca e Vitisë, **DETYROHET** e paditura K.N.P.SH. “Papenburg & Ardiani Company” me seli në Sojevë të Ferizajt, që paditësit t’ia kompensoj dëmin jo material dhe material në aksidentin e pësuar deri sa ishte duke punuar në orar të punës tek e paditura me datë 30.05.2013, me ç’rast paditësi kishte pësuar lëndime të rënda trupore, andaj duhet t’i kompensohet dëmi për këto kategori:

Kompensimi i dëmit jo material:

- Për dhimbjet fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, të rëndë, të mesëm e të ulët, shumën prej 3,700 Euro,
 - Për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor i shprehur në shkallën prej 16.6%, për shumën e pa kompensuar, shumën prej 2,200 Euro,
 - Për gjitha llojet e frikës duke përfshirë edhe ate primare, shumën prej 2,800 €,
 - Për ndihmën dhe kujdesin e personit tjetër për 60 ditë shumën prej 300 €,
 - Për ushqim të përforcuar brenda 80 ditëve pas lëndimit shumën prej 500 Euro,
- Gjithsej dëmi jo material 9,500 euro (nëntë mijë e pesëqind euro).

Kompensimi i dëmit material:

- Për shpenzimet e mjekimit klimatik – terapeutik, shumën prej 100 euro,
- Për shpenzimet në bazë të faturave për barna dhe shërbime tjera, shumën prej 397 euro.

Gjithsej dëmi jo material dhe material 9,997 euro (nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë euro).

Shumat e lartëcaktuara duhet t’ia kompensoi paditësit në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, me kamatë ligjore prej 8 %, për dëmin jo material duke filluar nga nga data e vendosjes përmes aktgjykimit të parë të datës 19.06.2018, kurse për dëmin material nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë me 22.01.2014, deri në pagesën definitive, nën kërcënim me përmbarrim të dhunshëm.

II. REFUZOHET kërkesëpadia për pjesën prej 5,460 Euro, si e pa bazuar.

III. Shpenzimet e procedurës kontestmore dhe atë: 104 Euro për përpilimin e padisë, 60 euro për taksën në padi, 1,070 € për përfaqësim të avokatit në tetë seanca gjyqësore secila nga 135 €, 150 Euro për shpërblimin e ekspertit të psikiatrisë, 185 euro për shpërblimin e ekspertit të mbrojtjes dhe sigurisë në punë dhe 150 euro për shpërblimin e ekspertit të mjekësisë së punës, apo gjithësej **1,719 Euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes padisë kishte paditur Kompaninë e sigurimeve “Kosova e Re” dhe K.N.P.SH. “Papenburg & Ardiani Company” me seli në Sojevë të Ferizajt. Ai përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, kishte theksuar se me datë 30.05.2013, deri sa punonte në vendin e tij të punës tek e paditura K.N.P.SH. “Papenburg Ardiani & Company” me seli në Sojevë të Ferizajt, kishte pësuar lëndime trupore, ndërsa kishte qenë i siguruar tek kompania e sigurimeve KS “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, pra kishte pasur policë të sigurimit për sigurim të personave nga aksidentet personale. Për këto pretendime paditësi kishte dorëzuar prova.

Të paditurës KS “Kosova e Re”, gjykata konform dispozitave të LPK-së, i kishte dërguar përgjigja në padi, ndërsa e paditura “Kosova e Re” kishte propozuar që gjykata të bie aktgjykim në bazë të pohimit, duke e pranuar kërkesëpadinë e paditësit, për aq sa mendonte se kishte përgjegjësi.

Përfaqësuesi i paditësit N.N, avokati Sahit Musa, në seancën përgatitore të datës 11.12.2015, në tërësi e kishte përsëritur padinë dhe kërkesëpadinë që e kishte dorëzuar në gjykatë. Kishte propozuar nxjerrjen e provave mjekësore duke propozuar dy ekspertë mjekësorë, njëri nga lëmi i ortopedisë dhe tjetrin nga lëmi i neuropsikiatrisë, për ta vlerësuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve dhe frikën e përjetuar nga ana e paditësit.

Gjykata kishte pranuar propozimin dhe kishte caktuar ekspert dr. Xhemajl Selmani, ortoped traumatolog dhe dr. Valdete Serreqi Alidema eksperte e psikiatrisë.

Ekzaminim i drejtpërdrejt paditësit N.N, iu kishte bërë edhe nga eksperti ortoped Dr. Xhemajl Selmani me datë 15.01.2016, i cili sipas këtij eksperti ai kishte pasur thyerje të zgjatimeve anësore të unazave të belit – L/2, L/3, thyerje të zgjatimeve stiloil të kockës së rrezorit të parakrahut të djathtë. Me një fjalë ky ekspert mjekësor të gjitha këto lëndime i kishte cilësuar, si lëndime të rënda trupore, të cilat kishin shkaktuar dhimbje posaqërisht të rënda për 60 minuta, të rënda 3 ditë, të mesme 28 ditë dhe të ulët kishte thënë posedon edhe sot.

Paditësi në aksident kishte pësuar zvoglim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 16.6 %.

Në të njëjtën seancë, paditësi drejtpërdrejt u ekzaminua edhe nga eksperti psikiatër Dr.Valdete Alidema Serreqi, e cila kishte vërejtur se paditësi kishte pësuar frikë primare disa sekonda, pastaj frikë sekondare e shkallës së lartë 24 orë, frikë sekondare të intenzitetit të mesëm 6 javë dhe të intenzitetit të ultë 6 muaj.

Ndihma e huaj tek paditësi ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 60 ditësh, sikur edhe ushqimi i përforcuar për 80 ditë. Por edhe rehabilitimi fizio-terapeutik-klimatik i nevojshëm për 30 ditë, brenda dy viteve të aksidentit.

Ndërsa, përfaqësuesi i paditësit kishte dorëzuar parashtresën me shkrim në gjykatë, me të cilën kishte precizuar kërkesëpadinë

Në seancën e datës 16.02.2016, përfaqësuesja e të paditurës KS “Kosova e Re” Nazlije Bejta pjesërisht e kishte kundërshtuar padinë për nga baza, për arsye se me policën e sigurimit me nr.20986, e datës 05.04.2013, për sigurimin e personave nga aksidenti personal, nuk është

mbuluar kërkesëpadia sa i përket dhimbjeve fizike dhe frikën, duke sqaruar edhe kategoritë kompensuese e sidomos zvoglimi i pergjithshëm i aktivitetit jetësor, të cilën kategori ta ta sqarojmë më vonë, duke i ofruar në fund paditësit nga kjo policë e sigurimit shumë prej 5,219 Euro, kështu që pasi paditësi kishte pranuar avans nga e paditura pas aksidentit shumen prej 500 Euro, atëher nga shuma prej 5,218 €, kishin mbetur 4,719 €, te cilat pas shume diskutimeve dhe pas leximit te provave, ishte arritur pajtimi gjyqësor mes paditësit dhe KS “Kosova e Re”, në seancën e datës 05.07.2017.

E paditura e dytë K.N.P.SH. “Papenburg Ardiani & Company” me seli në Sojevë të Ferizajt, e cila e kishte kontestuar kërkesëpadinë e paditësit, duke e trajtuar si të parakohshme dhe se të paditues së dytë i mungon legjitimiteti pasiv i palës.

Në seancën e datës 20.12.2016, i autorizuari avokati Hajredin Leka kishte deklaruar se paditësi ka qenë i mbuluar me policë sigurimi ne rast se pëson lëndime gjatë orarit të punës, e këtë policë e ka pasur edhe ditën e aksidentit. Andaj përgjegjësia ishte bartur tek e paditura “Kosova e Re”. Eshtë e parakohshme padia edhe me faktin se paditësi ne kundërshtim me nenin 78.1. te Ligjit të Punës paditësi ka kërkuar kompensim dëmi, pa e provuar dhe denoncuar çështjen në gjykatë. E paditura e dytë po ashtu e ka kompensuar paditësin, ku për këtë kishte dorëzuar dy prova, si dëshmi se paditësi ishte kompensuar deri sa ishte i pa aftë për punë. Ky përfaqësues kishte propozuar të dëgjohet dëshmitari Bajram Maliqi nga Gjilani.

Dëshmitari i të paditurës se dytë, Bajram Maliqi, i cili punon tek kjo e paditur mes tjerash kishte thënë se paditësi N.N duke punuar tek e paditura, ku ditën kritike kishte qenë duke punuar në kanalizimin nëntokësor atmosferik, apo në kanalin e hapur dhe kur ishte lënduar punëtori ai kishte qenë larg prej vendit të ngjarjes në distancë prej 800 m, tek vendi i ngjarjes kishte ardhur edhe inspektori i punës dhe policia e Kosovës. Gjykata kishte insistuar nga dëshmitari te di se ditën kritike helmetën, dorezat dhe pajisjet tjera a i kishte me vete paditësi, ndërsa dëshmitari kishte thënë se ndodhe jo rralë herë që për shkak te nxehtit punetoret edhe paditësi ti heqin ato. Edhe pse perfaqesuesi i të paditurës së dyte e kishte permendur se inspeksioni i punës kishte hartuar procesverbal, ky përfaqësues asnjëherë nuk kishte mundur ta siguroj atë procesverbal, si dhe procesin e policisë së Kosovës.

Në seancën e datës 22.02.2017, e paditura nuk kishte mundur ta siguroj procesverbalin e inspektoratit te punes te Ferizajt, pasi që sipas tij ky inspektorat nuk ka shënime per aksidentin ne fjalë. Po ashtu ky përfaqësues kishte propozuar nxjerrjen e ekspertizes se ekspertit te mbrojtjes dhe sigurisë në punë, per te vertetuar se e paditura a kishte ndermarrë masa paraprake per ta siguruar mbrojtjen ne pune të paditësit ditën kritike.

Në këtë seancë ishte degjuar dëshmitari Osman Maliqi, i cili punonte si bagerist ne ditën e aksidentit kur ishte lënduar paditësi Gezim Tahiri, i cili mer sytë e tij e kishte parë momentin kur kishte rreshqitur Gëzimi dhe kishte rënë në kanal. Dëshmitari kishte sqaruar se Gëzimi në ditën kritike e kishte pasur helmetën të vendosur në kokë, por në momentin kur kishte rreshqitur, atij helmeta i kishte rënë nga koka në tokë.

Edhe N.N, si palë ishte dëgjuar nga gjykata i cili kishte sqaruar rrethanën dhe momentin e rreshqitjes se tij kur ishte duke qendruar në kanal mbi gypin, i cili e kishte futur në gojën e gypit tjetër, por gjatë tërheqjes së zingjirit me të cilin ishte i lidhur gypi, ai kishte dalur nga goja e gypit tjetër dhe kishte rënë në dorën e tij, pasi kishte rënë me shpinë mbi gyp e pastaj në kanal. Ai kishte sqaruar se ditën kritike nuk kishte pasur këpucë të mbathura, përveç ato personale private të tij, e as helmetë edhe pse thellësia nga toka deri ne fund te kanalit ishte 3.30 metra. Kishte thene se ishte penguar te deklaroj se nuk kishte të mbathura këpucë të punës e helmeta, nga menaxheri teknik Mevlud Dervishi.

Paditësi ishte pyetur nga përfaqësuesi i të paditurës dhe ishte pergjigjur se as kur ishin pranë në punë tek e paditura nuk kishin pranë mjete mbrojtëse të punës, sepse nuk kishte pasur, por edhe asnjëherë nuk ishte informuar verbalisht, as me shkrim se si duhet te punohet që mos të

lëndohen. Në fakt, ai kishte thënë se këpucët e punës iu kishin dhënë njëherë, por ato ishin djegur menjëherë duke shtruar asfalt nga nxehtësia.

Gjykata lëndën ia kishte dorëzuar pasi që kishte caktu ekspertin e mbrojtjes dhe sigurisë në punë Doc.Dr.Ing. Hamid Nuredini. Konstatimet e ekspertit ishin se: punëdhënësi nuk kishte ndërmarr veprime të duhura në përputhje me Ligjin e Sigurisë në Punë, duke mos permbush detyrimet lidhur me ndërmarrjen e masave të nevojshme për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë parandalimin e rreziqeve në punë, ofrimin e informatave, trajnimeve, organizimit perkates dhe masave të duhura për punë, duke e sqaruar nje nga nje secilin nga këto leshime, duke ia atribuar tërë përgjegjësinë punëdhënësit, bazuar në detyrimet e parapara në dispozitën 1, të nenit 6, dispozitat 1.1; 1.2 ; 1.11 ; dhe dispozitën 2 të nenit 7 të Ligjit nr.04/L-161, për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, si dhe dispozitave 3, 4 dhe 5, të nenit 42, të Ligjit për Punë nr.03/L-212.

Ne seancën e datës 30.11.2017, përfaqësuesi i paditësit nuk e kishte kundërshtuar ekspertizën e ekspertit të mbrojtjes në punë.

Ndërsa përfaqësuesi i të paditurës avokat Hajredin Leka edhe në këtë seancë e kishte kontestuar legjitimitetin pasiv, me arsyetimin se kjo e paditur e kishte bërë sigurimin tek e paditura KS “Kosova e Re” andaj edhe e kishte bartur përgjegjësinë për ndonjë lëndim eventual të paditësit dhe punëtorëve të tjerë.

Ky përfaqësues ka paraqitur edhe vërejtjet në ekspertizën e ekspertit të punës, duke e arsyetuar vërejtjet se ekspertiza është nxjerr 4 vite pas lëndimit të paditësit, e nxjerrë pa dal në vendin e ngjarjes dhe në mungesë të provave nga inspektorati i punës, andaj është vështirë që të konsatohet edhe kontributi i paditësit në shkaktimin e aksidentit.

Në fund gjykata kishte vendosur që të ftohet eksperti ortoped-tramatolog që të deklarohet lidhur me mendimet e tij të dhënë në seancën e datës 15 janar 2016, si dhe ekspertin e mbrojtjes dhe sigurisë në punë Dr. Hamid Nuredini të dhene në ekspertizën e datës 06 nëntor 2016.

Prandaj, në sancen e radhes eksperti ortoped-tramatolog Xhemajl Selmani kishte mbetur në tërësi pranë ekspertizës të nxjerr me datë 15 janar 2016, kur ishte ekzaminuar paditësi, e sidomos e kishte arsyetuar shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor e cila ishte vlerësuar rreth 16.6% tek paditësi, për shkak të thyerjes të dy zgjatimeve anësore të unazave të belit dhe kufizimit të lëvizjeve të bylyzykut të dorës së djathtë. Në këtë seancë përfaqësuesi i të paditurës Papenburg, kishte hequr dorë nga sqarimi i ekspertit mjekësor të psikiatrisë.

Ndërsa, eksperti i mbrojtës dhe sigurisë në punë Dr. Ing Hamid Nuredini në tersi kishte mbetur pranë ekspertizës të cilën ia kishte dorëzuar gjykatës në formë të shkruar, duke e arsyetuar të njëjtën, andaj eksperti kishte thënë se si ekspert kishte qenë në terren ku ka ndodhur aksidenti, duke konstatuar se punëtori tani paditësi nuk e kishte pranuar urdhëresën e datës 20.05.2013, të nënshkruar nga udhëheqësi i punimeve Bajram Maliqi, punëdhënësi nuk kishte mbajtur trajnim se si duhet të silllet punëtori në punë, andaj paditësi nuk mbanë përgjegjësi duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit të Sigurisë në Punë dhe të Ligjit të Punës (për më tepër shiqo procesverbalin e seancës së datës 21.02.2018).

Në seancën e fundit të shqyrtimit kryesor me datë 16.05.2018, edhe pse ishte ftuar rregullisht nga gjykata nuk ishte paraqitur në seancë përfaqësuesi i të paditurës, andaj gjykata kishte miratuar propozimin e palës paditëse që seanca të mbahej në mungesë të palës së paditur.

Avokati, atëherë Sahit Musa kishte mbetur në tersi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe ekspertizave të ndryshme të kryera për këto çështje konkrete, duke theksuar se me perfundimin e ekspertizës së ekspertit të mbrojtjes në punë dr.Ing. Hamid Nuredini është vërtetuar gjendja faktike e shëndetit të paditësit Gezim Tahiri, në mënyrë shkencore se paditësi ka pësuar lëndime trupore në vendin e punës ku punëdhënësi ka qenë i detyruar të zbatoj masat parandaluese bazuar në parimet e përgjithshme të parandalimit, andaj në këto rast punëdhënësi

mbanë tërë përgjegjësinë bazuar në detyrimet në parimet e përgjithshme lidhur me mbrojtjen në punë. Gjithashtu ishte bere edhe vlerësimi i ekspertit të mjekësisë së punës Dr. Tafil Xhekaj, i cili në baze të dokumentacionit të shtjelluar në shresat e lëndës ka ardhë në përfundim se të paditësi është i shprehur zvoglimi i aftësisë së punës, në shkallë prej 16.25%, ku qartë shifet se paditësi me një shkallë të tillë ka humbur zvoglimin e aktivitetit punës.

Gjykata përmes aktgjykimit C.nr.24/2014, me datë 16.05.2018, kishte vendosur që paditësit t'ia miratoi pjesërisht kërkesëpadinë, por pas ankesës së paditësit dhe të paditurës K.N.P.SH. "Papenburg & Ardiani Company" Gjykata e Apelit i kishte pranuar si të bazuara ankesat dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata kishte caktuar seancën përgatitore me datë 10.12.2020, ku pala paditëse kishte vazhduar të mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ndërsa pala e paditur kishte mbetur pranë pretendimeve se, si e paditur nuk ka legjitimitet real pasiv, pasi se e paditura përmes kontratës mbi sigurimin vullnetar nga aksidentet përgjegjësinë e ka bartur tek kompania e sigurimeve "Kosova e Re", përmes polices së sigurimit nr.20986 për vitin 2013, dhe atë për gjitha kategoritë e demit eventual.

Pas këtij moment ishte rritur dilemma se, vërtetë nuk dihej se çka ishte siguruar me policën e sigurimit të KS "Kosova e Re" e çka jo, për punëtorët e edhe për paditësin në rast se lëndohen në punë. Me qenë se ishte edhe udhëzimit nga Gjykata e Apelit, gjykata kishte vendosur që për seancën e radhës të ftohet përfaqësuesja ligjore e KS "Kosova e Re", për ta kuptuar se cilat kategori kompensuese ishin mbuluar dhe deri sa ishin mbuluar kategoritë që duhej të kompensoheshin.

Përfaqësuesja ligjore e KS "Kosova e Re" e cila kompani edhe kishte lëshuar policën e sigurimit nr.20986, datë 06.04.2013, kishte sqaruar se policia kishte mbuluar kategoritë: vdekja nga aksidenti, invaliditetin e plotë, shpenzimet mjekësore dhe kompensimin ditor. Kurse kategoritë që nuk janë të mbuluara me policë janë: dhimbjet fizike, frikën, ndihmën nga personi i tretë, ushqimin e përforcuar, rehabilitimin fizioterapeutik, zvoglimin e aftësisë punuese.

Kategorinë e invaliditetit të plotë, ajo kishte sqaruar se po të ishte i shkallës së plotë invaliditeti, apo 100%, sipas polices nr.20986, mbulesa kishte qenë deri në 24,000 € për një punëtor. Por në rastin konkret me qenë se paditësi N.N kishte zvoglim të aktivitetit jetësor vetëm 16.6%, policia e kishte mbulesë vetëm shumë prej 3,894 €, pra i siguruari "Papenburg & Ardiani Company", vetëm për aq kishte paguar primin. Shpenzime mjekësore maksimalisht ishin vetëm deri 2,000 euro, ndërsa në rastin konkret KS "Kosova e Re" paditësit i kishte kompensuar shumë vetëm për 187.80 €, ndërsa kompensimi ditor sipas polices ishte 8 euro në ditë, e që paditësi ishte kompensuar për këtë formë me 1,048 €, apo gjithsej ishte kompensuar me 5,219 euro.

Pra, sipas këtij sqarimi u kuptua se çka ishte kompensuar nga e paditura KS "Kosova e Re" e çka kishte mbetur pa u kompensuar.

Kategoria e zvoglimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor tek paditësi edhe pse kishte zvoglim në shkallën prej 16.6%, ai nga e paditura "Kosova e Re" ishte kompensuar vetëm me 3,894 euro. Për seancë edhe pse rregullisht ishte ftuar përfaqësuesi i të paditurës, ai ftesës nuk iu ishte përgjigjur, andaj gjykata kishte caktuar seancën e radhës për datën 16.03.2021.

Pala paditëse kishte paralajmëruar saktësimin e padisë, e të cilën e kishte bërë ku nga e paditura kishte kërkuar shumë totale prej 15,457 €.

Në seancën e datës 16.03.2021, përsëri edhe pse rregullisht i ftuar, pala e paditur nuk ishte paraqitur në seancë. Ndërsa, përfaqësuesi i paditësit për kategoritë e pa kompensuar nga ish e paditura KS "Kosova e Re" kishte kërkuar kompensim, ndërsa duke pretenduar se për kategorinë e zvoglimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor i shprehur në shkallën prej 16.6% tek paditësi shuma e kompensuar prej 3,894 €, është e pa mjaftueshme, kishte kërkuar

kompensim edhe nga e paditura “Papenburg & Ardiani Company” në shumë prej 2,300 €. Për të gjitha shumat, kishte kërkuar edhe kamatën prej 8%, duke e llogaritur nga paraqitja e padisë, deri në pagesën definitive.

Gjykata kishte lexuar dhe administruar provat si; Raportin e emergjencës pranë Spitalit Rajonal në Ferizaj, me nr.632 i datës 30.05.2013, policia e sigurimit, nr.20986, e datës 05.04.2013, e lëshuar nga KS “Kosova e Re“ për të siguruarin K.N.P.SH, “Papenburg Ardiani Company”, në Ferizaj, ku përfshihej edhe paditësi N.N, raporti i emergjences pranë QKUK-se, nr., 16989 i datës 30.05.2013, në emër të N.Nt, fletlëshimi me nr. amëz 1017 i datës 10.06.2013, fletlëshimi me nr.984 nga dt.30.05.2013, deri me 04.06.2013, nje raport me nr.14863 i datës 24.12.2013, fatura me nr.1812, e datës 01.05.2013, në shumë prej 130 euro, te leshuara nga ORFO “MEDIKA”ne Prishtine, fatura me nr. 3820/2, datë 20.08.2013, në shumë prej 100 euro, e lëshuar nga Q.K.M.F. “Banja e Klllokotit” në Klllokot, gjendja fillestare bankare pranë RBKO, në emër të N.Nt, 8 dëftesa për participim mjekësor në vlerë totale prej 41 euro, fletlëshimi me nr. 3986 i datës 20.08.2013, deri më datë 31.08.2013, i leshuar nga “Banja e Klllokotit”, raporti mjekësor i Klinikës se kirurgjisë “Aloka” i datës 05.10.2015, raporti specialistik i Ambulancës në Ferizaj, reparti i Neurokirurgjisë për paditësin N.N, i datës 23.10.2014, raporti i cete-së datë 29.11.2013, i lëshuar nga mjeku Dr.Serbeze Kabashi, radiologe, vertetimi i datës 06.02.2014, i lëshuar nga e paditura “Papenburg Ardiani Company”, ekspertiza e ekspertit te mbrojtjes dhe sigurisë në punë dr.ing. Hamid Nuredini, e datës 06.11.2017, tre kupna fiskal, me numra te ndryshëm serik në shumë të pergjithshme prej 126 euro, ekspertiza – raporti i ekspertit të mjekësisë së punës, Dr.Tafil Xhekaj e datës 11.04.2018, transferi i pagesës për ekspertin ortoped tramatolog dr. Xhemajl Selmani, në shumë prej 150 euro, e datës 23.02.2018, si dhe fletdeponimi në shumë prej 150 euro, për eksertin e mjekësisë se punës Tafil Xhekaj i datës 11.04.2018. Pala prezente nuk i kishte kundërshtuar provat e lexuara.

Në fjalën përfundimtare përfaqësusi i paditësit N.N, av. Liman Musa kishte thënë se në bazë të gjitha thënieve ne sancat paraprake, propozimeve, ekspertizat te ndryshme, është vërtetuar baza juridike lidhur me kompenzimin e demit material dhe jo material për paditësin N.N, duke deklaruar se edhe vërejtjet e dhëna nga Gjykata e Apelit, tanimë janë eliminuar.

Kishte kërkuar edhe shpenzimet e pcedurës edhe atë: sipas aktgjykimit të parë C.nr.24/2014, në vlerë prej 1,424 €, si dhe për përfaqësime në 3 seanca gjyqësore në këto shqyrtime, ku për një seacë kishte kërkuar shumën prej 270.40 euro, gjithesej 811.20 euro, apo në total i bie se kishte kërkuar shumën prej 2,235.20 €.

Gjykata me kujdesë provat i ka çmuar dhe vlerësuar veç e veç dhe si tërësi bazuar në nenin 8, të LPK-së, duke konstatuar se:

Me leximin e Raportit të emergjencës pranë Spitalit Rajonal në Ferizaj, me nr.632 i datës 30.05.2013, gjykata vërteton se paditësi N.N ishte aksidentuar deri sa kishte punuar tek i padituri K.N.P.SH. “Papenburg & Ardiani Company” gjatë punimeve në rrugë. Po ashtu vërtetohet se paditësi është sjellur në këtë shërbim për lëndimet e marra në aksident, e kjo vërtetohet edhe me raportet tjera mjekësore, të reparteve të ndryshme dhe ordinancave të ndryshme.

Me leximin e policës së sigurimit, nr. 20986, e lëshuar nga KS “Kosova e Re“ për të siguruarin K.N.P.SH, “Papenburg Ardiani Company”, në Ferizaj, natyrisht edhe për paditësin N.N, gjykata konstaton se kompania “Papenburg” kishte siguruar paditësin në rast të aksidentit personal, tek Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, për këto kategori: ne rast te vdekjes nga aksidenti, invaliditetit te plotë, shpenzimet mjekësore dhe për kompenzimin ditor, nëse ka munguar paditësi në punë. Me këtë policë apo sigurim nuk ishin mbuluar dhimbjet fizike, frika, shpenzimet për ndihmen nga personi i tretë, ushqimin e përforcuar, ato për rehabilitim klimatik, zvoglimi i aftësisë punuese.

Sipas policës së sigurimit edhe pse është mbuluar kategoria e zvoglimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor tek paditësi nga “Kosova e Re”, kjo kategori nuk ishte kompensuar në tërësi nga ish e paditur KS “Kosova e Re”, pasi që vlera e primit të paguar nga tani e paditura K.N.P.SH. “Papenburg & Ardiani Company” ishte e vogël për ta kompensuar plotësisht paditësin për këtë kategori, andaj gjykata ka vendosur që ta obligoj tani të paditurën ta paguaj meritorisht këtë kategori, bazuar në shkallën e zvoglimit prej 16.6%, duke e detyruar të paditurën ta kryej dhe plotësoj kompensimin edhe për 2,300 euro, pasi që e paditura “Kosova e Re” paditësin e kishte kompensuar vetëm me shumën me 3,894 euro.

Ndërsa, me leximin e raportit të emergjencës pranë QKUK-se, nr.16989, i datës 30.05.2013, në emër të N.Nt, fletlëshimi me nr.984 dhe fletlëshimit me nr. amëz 1017, i datës 10.06.2013, gjykata vërteton se paditësi ishte derguar në qendren emergjente pranë QKUK-së në Prishtinë menjëherë pas dhenies se ndihmës së parë në emergjencën e Ferizaj, ndërsa kishte qëndruar i shtrirë në Klinikën e ortopedisë me traumatologji nga data 30.05.2013 deri me 10.06.2013, për shkak të frakturave në trup.

Me leximin e fletlëshimit me nr. 3986 i datës 20.08.2013, deri me 31.08.2013, i leshuar nga “Banja e Kllokotit” gjykata vërteton se paditësi kishte qenë në rehabilitim klimatik për 10 ditë, ku edhe kishte paguar mjete materiale.

Me leximin e ekspertizës mjekësore gjyqësore të ekspertit ortoped-traumatolog Dr. Xhemajl Selmani, e ekzaminuar më datë 15.01.2016 gjykata konstaton se ky ekspert në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe të ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësit, ka konstatuar se paditësi në këtë aksident kishte përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë për 60 minuta , të rëndë 3 ditë, të mesëm 28 ditë dhe të ulët, kishte pasur nevojë për ndihmën nga personi i tretë 60 ditë, për ushqim të përforcuar 80 ditë dhe rehabilitim fizioterapeutik-klimatik në ndonjë banjë 30 ditë në dy vitet pas aksidentit. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor kishte pasur në shkallën prej 16.6%.

Me leximin e ekspertizës mjekësore të ekspertes psikiatër Dr. Valdete Serreqi Alidema, gjykata konstaton se kjo eksperte në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe të ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësit në seancë, ka konstatuar se paditësi në këtë aksident në punë kishte përjetuar dhe manifestuar me gjitha llojet e frikës, duke përfshirë edhe atë primare.

Si prova dominuese gjykata vlerëson raportin e emergjencës në Spitalin Rajonal në Ferizaj, me nr.632 i datës 30.05.2013, përmes së cilit raport ishte vërtetuar edhe fakti se vërtetë paditësi ishte lënduar deri sa punonte tek e paditura, pra në vendin e punës, por dhe ekspertiza e ekspertit të mbrojtjes dhe sigurisë në punë dr.ing. Hamid Nuredini, e datës 06.11.2017, e cila përgjegjëse ekskluzive e bënë të paditurën “Papenburg”, për lëshimet që i kemi cekur më lart. Gjykata ka bërë vlerësimin edhe të dëshmitarëve si të Osman Maliqi, i cili kishte qenë prezent në momentin e aksidentit, pastaj deklaratën e vetë palës paditëse.

Ndërsa, si tërsi këto prova paraqesin bazë të mjaftueshme dhe të sigurt për ekzistimin e bazës juridike dhe themelsisë së ekzistimit të kërkesës së paditësit, ndaj tani të paditurës K.N.P.SH. “Papenburg & Ardiani Company”.

Edhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse gjykata i ka pasur parasysh që nga fillimi i paraqitjes së tyre, siç ishte pretendimi i palës së paditur, se kjo çështje duhet të hedhet poshtë me faktin se tanimë është gjykuar, pasi paditësi dhe KS “Kosova e Re” kanë lidhur pajtimin gjyqësor. Një pretendim të tillë gjykata nuk mund ta pranoj, ngase siç kemi thënë polica e sigurimit kishte mbuluar vetëm vdekjen eventuale nga aksidenti, invaliditetin e plotë, shpenzimet mjekësore dhe kompensimin ditor. Kurse kategoritë që nuk ishin të mbuluara me police si dhimbjet fizike, frikën, ndihmën nga personi i tretë, ushqimin e përforcuar, rehabilitimin fizioterapeutik dhe zvoglimin e aftësisë punuese, gjykata tani i ka gjykuar, pasi që këto kategori nuk ishin

përfshirë me pajtimin gjyqësor C.nr.24/14, të lidhur me datë 05.07.2017, ndërmjet paditësit N.N dhe ish të paditurës KS “Kosova e Re”.

Edhe pretendimet tjera të palës së paditur nuk ishin të bazuara, si pretendimi se edhe paditësi ka pasur kontribut, nuk kishte qenë mjaft i vëmendshëm e tjera, pastaj se të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv i palës, pra të gjitha këto pretendime i kishte bërë të pa qëndrueshme ekspertiza e ekspertit të mbrojtjes dhe sigurisë në punë Doc.dr.ing. Hamid Nuredini dhe përmbajtja e policës së sigurimit.

Nuk ishte kontestuese fakti se K.N.P.SH, “Papenburg & Ardiani Company” dhe KS “Kosova e Re” kishin lidhur marrëveshjen për sigurimin kolektiv nga aksidentet personale, duke përfshirë edhe paditësin N.N, i cili nuk kontestohet se punonte tek e paditura.

E paditura K.N.P.SH, “Papenburg & Ardiani Company” si punëdhënësi i përgjigjet paditësit për dëmin e shkaktuar në kuptim të dispozitave të nenit 2.10. të Ligjit për Mbrojtjen në Punë, mbrojtja e shendetit të punësuarve në rrethin ku punojnë Ligji nr.2003/19, sipas parimit të përgjegjësisë objektive (të lidhjes kauzale), duke marrë parasysh faktin se kryerja e punëve ndërtimore paraqet veprimtari të rrezikshme nga e cila kercënohet rreziku më i madh në shkaktimin e aksidenteve. Përgjegjësia materialo juridike e të paditurës buron nga kryerja e veprimtarisë së rrezikshme në kuptim të nenit 154 dhe 155 të LMD-së, me të cilin është rregulluar se dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, respektivisht me veprimtarinë e rrezikshme, konsiderohet se rrjedh nga ky send, përveç nëse vërtetohet se ai nuk ka qenë shkaktar i dëmit. Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet pronari i sendit, kurse për sendin nga veprimtaria e rrezikshme, përgjigjet personi që merret me atë veprimtari.

Është parim i përgjithshëm se çdo klush që dikujt i shkaktonte dëm, është i obliguar ta kompensojë, nëse nuk e argumenton se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Në rastin konkret me provat e administruara nuk është argumentuar faji i paditësit dhe se paditësi është lënduar gjatë kryerjes së detyrave të rregullta të punës.

Neni 157.4, i LMD-së thot: *“Pronari i sendit të rrezikshëm i cili ia ka besuar atë personit që nuk është i aftësuar, apo nuk është i autorizuar të manipuloj me atë, përgjigjet për dëmin që rrjedh nga ky send”*. Ndërsa, sipas ekspertit të mbrojtjes dhe sigurisë në punë, tanimë ishte konstatuar se paditësi nuk ishte aftësuar dhe trajnuar për kryerjen e punëve, nga të cilat kishte rrjedhur aksidenti dhe lëndimet në punë.

Me shtjellimin dhe vlerësimin e provave, gjykata e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike në këtë çështje juridike, duke vendosur me bindje të lirë. Me vërtetimin e gjendjes faktike, gjykata ka përfunduar se kërkesëpadia e paditësit është vetëm pjesërisht e bazuar. Këtë përfundim gjykata e bazon në provat dhe shkresat në lëndë, ku paditësi në aksidentin e datës 30.05.2013, deri sa kishte punuar në vendin e tij të punës, kishte marr lëndime të rënda trupore, duke marr për bazë edhe ekspertizat e ekspertit të psikiatrisë Dr. Valdete Serreqi Alidema dhe ekspertit ortoped-traumatolog Dr. Xhemajl Selmani, të cilët pas ekzaminimit të paditësit dhe dokumentacionit mjekësor kanë konstatuar se paditësi nga ky aksident kishte marr lëndime të rënda trupore, kishte përjetuar dhimbje, frikë dhe pasoja tjera, pastaj dhimbjet fizike të të gjitha llojeve, ku të njëjtit sipas vlerësimit të lirë i ka përcaktuar kompensimin e dëmit, ashtu si është përcaktuar më afër në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Me këtë përfundim gjykata vlerëson se me shumat e gjykuara paditësit do t'i shërbejnë si një shpërblim real për të gjithë atë që e ka përjetuar në këtë aksident në vendin e punës.

Gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit për shumat më të larta se ato të gjykuara, me arsyetim se një kërkesë e tillë e paditësit nuk ka mbështetje në vlerësimin real të dëmit jo material.

Kërkesën për kompensimin plotësues të kategorisë së zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor edhe për 2,300 €, për shkallën prej 16.6% të këtij zvoglumi, kjo gjykatë e ka miratuar, pasi që paditësit kjo kategori kompensuese në pajtimin gjyqësor të arritur me datë 05.07.2017, iu ishte kompensuar-shpërblyer nga e paditura KS “Kosova e Re”, vetëm pjesërisht, aq sa kishte paguar primin-mbulesën i siguruari, tani e paditura K.N.P.SH. “Papenburg & Ardiani Company”.

Gjykata vendimin për aprovimin e kërkesëpadiisë e bazoi në dispozitën ligjore të nenit 183, të LMD-së i ri, duke i caktuar shumat sipas bazuar në provat e ekzaminuara dhe çmuarjes së lirë. Gjykata paditësit nuk ia ka pranuar kompensimin për shpenzimet e procedurës siç i kishte kërkuar i autorizuari i tij, me faktin se disa prej tyre ju ishin kompensuar nga e paditura KS “Kosova e Re” përmes Pajtimit Gjyqësor” të arritur me datë 05.07.2017, siç ishin: taksa për padi prej 40 €, shpërblimi për ekspertin e ortopedisë prej 150 € dhe kompensimin për përfaqësimin e avokatit në pesë seanca gjyqësore, ku për gjitha këto paditësi ishte kompensuar me 810 euro.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është bazuar në bazë të nenit 452.1, të LPK-së, ndërsa shpenzimet lidhur me lartësinë e shkallës së kamatës duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së.

Nga të cekurat më lartë dhe bindjes së lirë të gjykatës është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË VITI
C.nr.937/2020
Më:16.03.2021

Gj y q t a r i
Raif Fazliu

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, 15 ditë pas ditës së pranimit të njejtit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.